

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës! - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/gjkkko-nuk-mund-te-jete-zgjatim-i-313es
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 14:34:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 08:47:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b43a299544fbd1c0b5c44f9c2ad38494f2d4821c4a16fa0a42b585cec80c0c50
TEKSTI	01e90fa9f224709fa49f62fd6a182adfada1b7c8d34f9d567b560186153bde2b
PAMJA	d1006b6bb3a22513ebbd1d00802864acfbb1157ca198cc1362634a575ab4263e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c397229b354be09f70a299b43a9788fdb72eb39926feef7d2fee6ba16fb0b71a
E MËPARSHMJA	6d0caae019d032556d4419678458b9e4af419018d4f734eed4a84c19dda952fd
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c397229b354be09f70a299b43a9788fdb72eb39926feef7d2fee6ba16fb0b71a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Putin: Rusia nuk ka qëllime agresive, gati për të rivendosur marrëdhëniet



Opinion

GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës!

Kur hyn në gjykatë, hyn në një sallë publike gjykimi, jo në një regjim paraburgimi ku të detyrojnë të heqësh edhe lidhëset e këpucëve. Gjykata nuk është qeli. Avokati nuk është i paraburgosur.



Ylli Manjani

6 Shtator, 10:45 | Përditësimi: 6 Shtator, 10:47

Share Tweet

A A

Ndalimi i avokatit Dorian Matia të hyjë në sallën e gjyqit nga Garda e Republikës është një provë flagrante se si një drejtues, i komanduar madje, GJKKO-së mund të cënojë procesin e rregullt gjyqësor. Ai ka nxjerrë një rregullore sigurie që ngjan më shumë me logjikën e shtetit policor sesa me standardet e një gjykate në një demokraci kushtetuese.

Sa herë pushteti fillon ta justifikojë paudhësitë e veta përdor me argumentin siguri. Sa herë përdoret kjo fjalë duhet të ndizet alarmi demokratik.

Pyetja e vërtetë është çfarë do të fshehë më shumë se sa çfsheh deri më sot GJKKO?! Se kjo rregullore ngjan më tepër si kolla që kërkon të fshehë pordhët. Asnjë lidhje nuk ka me sigurinë.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Rregullorja censuruese e GJKKO/ OSBE për Report TV: Kufizimet e përgjithshme të vendosura ndaj medias shkelin parimin e transparencës të zgjedhur nga KLGJ

Historia ka treguar se, në emër të sigurisë, demokracia është goditur gjithmonë më fort se çdo rrezik që pretendohet të shmangej. Dhe kur vetë gjykatat vendosin ta sakrifikojnë procesin e rregullt për "sigurinë" e godinës së tyre, atëherë goditet vetë arsyja pse ekzistojnë.

Këtë herë, në emër të sigurisë së një pjese të godinës së GJKKO-së, është goditur një nga themelet e procesit të drejtë: e drejta e qytetarit për t'u mbrojtur nga avokati që ka zgjedhur vetë. Bashkë me të bien edhe kontradiktoriteti, barazia e armëve dhe garancia për një gjykim të drejtë e të paanshëm.

Dhe e gjitha kjo për shkak të një rregulloreje kokëfortë, e cila duket se e trajton avokatin dhe celularin e tij/saj si një rrezik potencial për sigurinë e gjykatës.



Hë, Enver Hoxha, ku je?
Erdhi prapë dita jote.

Madje jo në ndonjë burg, por në mes të një gjykate që Perëndimi demokratik e paraqet si model të reformës në drejtësi.

Hë, ua lumsha!
Siguri ore ejiji!

Po kush ua cenoj sigurinë?!

Kur kjo gjykatë ruhej nga Policia e Burgjeve, nuk pati asnjë incident sigurie. Nuk mbahet mend ndonjë avokat të ketë shkaktuar rrëmujë, të ketë cenuar rendin apo të ketë rrezikuar gjykatën me celularin në xhep.

Pra praktika nuk paska vlerë. Mjafton dëshira për të treguar pushtet administrativ.

Por ligjet e këtij vendi nuk i ka shkruar administrata e GJKKO-së. Ligji i ka dhënë gjyqtarit autoritetin absolut për të drejtuar seancën dhe për të vendosur rregullat e sjelljes në sallën e gjyqit. Nuk ia ka deleguar këtë kompetencë Gardës së Republikës dhe as një rregulloreje të brendshme.

Këtu lind edhe një pyetje tjetër me këtë rast: çfarë bën Garda e Republikës brenda një gjykate? Garda është institucion për mbrojtjen e personaliteteve dhe objekteve të përcaktuara me ligj, jo organ që vendos kush hyn e kush nuk hyn në një proces gjyqësor.

Përgjigjen për këtë e di vetëm një qeveri. Ose ndoshta e di më mirë komisioni Xhafaj.

Jetojmë në epokën e teknologjisë ore ejijiji, jo në kohën e mbylljeve mesjetare. Kur hyn në gjykatë, hyn në një sallë publike gjykimi, jo në një regjim paraburgimi ku të detyrojnë të heqësh edhe lidhëset e këpucëve. Gjykata nuk është qeli. Avokati nuk është i paraburgosur.

Ejiji!
Ouuuuu!
Jeni në këtë realitet apo jo?!

Kjo është e papranueshme!
Të paktën për aq kohë sa ky shtet pretendon se njeh profesionin e avokatit, median e lirë dhe procesin publik të gjykimit.

Nëse të gjitha këto mund të anashkalohej me një rregullore administrative, atëherë ç'kuptim ka rendi kushtetues i normave? Ç'na duhen Kushtetuta, ligjet dhe gjykatat, nëse një akt administrativ mund t'i nxjerrë jashtë funksioni?

Atëherë le ta pranojmë hapur: ta shpallim GJKKO-në zgjatim funksional të 313-ës dhe të biem rehat të gjithë. Të paktën nuk do të shtiremi më sikur po zhvillojmë gjyqe të hapura në një shtet demokratik.

Sepse me këto falsitete nuk vazhdohet më.

Do jem pjesë e çdo greve që duhet të shpallë Dhoma e Avokatisë!/**TemA**

P.J/Shqiptarja.com

TAG: [ylli manjani](#) [GJKKO](#) [rregullorja e GJKKO](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?  4.1 / 5 (10 vlerësime)

 OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Mara emigrante ne Itali:

06/09/2026 11:33

Jo vetem ti z. YLLI por e gjithë Shqipëria do te jete ne proteste per kete drejtesi te dhjere .

Përgjigju



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

[Të drejtë](#)

[Të gabuar](#)

[Nuk e di](#)

Lajme të tjera





Dosja 'AKSHI'/ Zhdukta 950 mijë euro verëra të sekuestruara në vilën e Ergys Agasit, GJKKO në lë burg kushëririn e tij, Eno Agasi



Keti Banushi

18 Shtator, 13:51



Ylli Manjani: Ku e lamë?!... Te rregullorja



Ylli Manjani

18 Shtator, 10:04



GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, Haxhia: Qëndrim i turpshëm, përshkallëzohet bojkotin

17 Shtator, 15:27



GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore! Haxhia: Përshkallëzohet bojkotin (DOKUMENTI)



Keti Banushi

17 Shtator, 11:09



Rregullorja censuruese e GJKKO, kreu i avokatëve për Report Tv: Vijon bojkoti, do mbledhemi sërish, radikalizohet qëndrimin tonë



Keti Banushi

16 Shtator, 13:24



Gjykata e Lartë la në qeli Veliajn/ Duraj: Sot ai duhet të ishte ulur në tryezën e kryebashkiakut! Karanxha: Në Shqipëri është bërë modë mosrespektimi i vendimeve të Kushtetueses

15 Shtator, 23:02



Gjykata e Lartë la në qeli Veliajn/ Muharremi: Vendim surprizues! Tirana është pa kokë, qytetarët po vuajnë rënien e ritmit të punës! Reçi: Handikap ligjor, kemi një kod penal fashist!

15 Shtator, 18:34



Ilir Meta mbetet në qeli, GJKKO i rrëzon sërish kërkesën për liri! I refuzohet edhe dalja nga kafazi

15 Shtator, 12:18



GJKKO jep 50 vite burg për 7 të pandehurit e dosjes 'Revanshi'! 10 vite e 8 muaj burg për Durim Bamin, dënohet edhe nipi i Astrit Avdyllit dhe ish-efektivi Morina

15 Shtator, 09:35



'Arresti' i Veliajt nesër në Gjykatë të Lartë, Bardhi: Rama po bën gjithçka për ta nxjerrë nga qelia, ndërkombëtarët të monitorojnë procesin

14 Shtator, 19:25



Ngërçi i pagave/ Avokati Çela: Qeveria asnjëherë nuk u ka dhënë magjistratëve atë që është përcaktuar me ligj! Fociro: Rama po ushtron presion ndaj drejtësisë, kërkon ta vërë nën kontroll (VIDEO)

14 Shtator, 17:58



2 javë pasi u transferua Ergys Agasi, SPAK urdhëron kontrolle 'blic' në burgun e Bradasheshit, zbulohet alkool dhe një pajisje për internet

14 Shtator, 15:24

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptaria.com]

Kerko

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.